



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, të nenit 16 par. 1, shkronja **b** dhe të neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.03.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
“KODRA E TRIMAVE II” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Kodra e Trimave II” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar si “Kodra e Trimave II”, e cila shtrihet në anën veriore të qytetit, duke filluar nga Xhamia e Llapit, vazhdon në anën lindore me rrugën “Bajram Bahtiri” deri në pikëtakimin me “Unazën e brendshme” në anën veriore, përgjatë kësaj unaze deri në pikëtakimin me rrugën “Vëllezërit Fazliu” në anën perëndimore, për të arritur te pika fillestare -Xhamia e Llapit.

Sipërfaqja që do të trajtohet në këtë plan rregullues është ~ 575ha .

Kufijtë e përshkruar të hapësirës nga par.1 i këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartësi i detyrave programore dhe hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit.

Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara të sigurojnë dhe t’i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizimit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, për të cilat konsiderohet se janë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendim të Kuvendit të Komunës së Prishtinës si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat e qytetarëve për zhvillim të punimeve do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësin e inkorporimit të lokacionit përkatës në planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr. 35-1019, më 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNËS

Prof. dr. Isa Mustafa